



Elbasani vazhdon te komandoj renditjen e kampionatit te kategorise se pare. Fitorja e arritur sot ne qytetin e Pogradecit i jep me teper siguri "portokallinjeve". Skuadra e Files eshte shkeputur dy pike me shume dhe ndaj skuadres se vendit te dyte, Aplolonise. Fieraket nuk kane shkuar me shume se barazimi 0-0, ndaj kamzalinjeve, ne ndeshjen e zhvilluar ne fushen asnjane te Beratit. Ne ndeshjet e tjera ajo qe perben surprizen ishte skuadra e Terbunit te Pukes e cila ka fituar me rezultat te thelle 5-1, ne transferte ndaj skuadres se vendit te fundit, Mamunrrasit. Takimi mes tyre eshte zhvilluar ne fushen asnjane te Yrshekut. Vete rezultati i arritur ne perfundiim te ndeshjes flet qarte per lojen qe zhvilluan skuadrat. Fitore te rendesishme ka marre dhe skuadra e Himares . Dygoleshi i Dervishit i ka dhene me shume siguri skuadres himariote e cila e sheh vehten ne vendion e dhjete ne renditje. Sarandjotet me fitoren e arritur para sportdashesve te tyre ku ka mundur me loje dhe rezultat skuadren e Burrelit, jane ngjitur ne renditje. Burreli duhet pranuar qe nuk po kalon momente te mira ne kete kampionat. Fitorja e ka ngjitur skuadren e Hysit ne vendin e trete, c'ka i shton ketij kampionati dhe nje pretendent me shume per te synuar kalimin sezonin e ardhshem ne kampionatin e me te mireve. Peqinasit bene nje hap fals ne Patos, ndaj Albetrolit. Formacioni i Branices konsiderohej favorit ndaj debutuesve, por barazimi 1-1 ia veshtireson Peqinasve mundesite per tu rikthyer na kampionatn e superliges Ne barazim perfundoi dhe ndeshja e zhvilluar ne Puke mes Ades dhe Velecikut. Ndeshja mes tyre u zhvillua disa minuta me vonese per shkak te reshjeve te bores . Futbollistet e Ades pothuajse gjate gjithe takimit kane luajtur me nje lojtar me pak, pasi Tole u ndeshkua me karton te kuq. Nderkohe goli i Ahmetajt ne minute e 71-te te ndeshjes i mban blute ne vendin e gjashte me 18 pike. Beratasit te pozicionuar ne vendin e tete do ta kene shume te veshtire qe ti afrohet skuadrave te kreut, per vete ecurine jo te mire qe kane patur ne kete kampionat. Ndeshjet e javes se 13 – te do te zhvilohen javen e ardheshme, ku spikat kryendeshja mes Elbasanit dhe Aplonise qe do te jete ne qender te vemendjes

Ndeshjet e javes se 12 – te Kategorise se pare.

1. Dinamo – Tomorri 1-0

Shenues : Aahmetaj 71'

2. Butrinti - Burreli 4-2

Shenues : Dalipaj 21' , Bytyci 50', Raboshta 62', Bazaj 73' Dautaj 90'(11m), Pepaj 90+2

3. Veleciku – Ada 1-1

Shenues : Fishta 86' Pepa 21'

4. Albetroi - Shkumbini 1-1

Shenues : Bratja 63', Qemeri 33(Autog)

5. Himara – Luftetari 2-0

Shenues : Dervishi 63' 82'

6. Mamurrasi - Terbuni 1-5

Shenues : Lama 66 ' , Agasrta 16', 35', Lagerta 60', Mziu 80, 82

7. Pogradeci - Elbasani 0-1

Kategoria 1/ Elbasani mund Pogradecin, Terbuni "shkaterron" Mamurrasit

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 30 Nentor 2013 17:12

Shënues: Hila 51'

8. Apolonia – Kamza 0-0